

Ligjerata 2

I. Metodatat kërkimore në psikologji

II. Fushat e Psikologjisë

Fushat e Psikologjisë

Larmia e pafund e fushave të psikologjisë përfshin 54 seksione që veprojnë në botë siç është psikologjia ushtarake, psikologjia e familjes, psikologjia e medias, psikologjia e arteve, psikoanaliza etj të cilat kontibudojnë dhe intervenojnë në shumë probleme që has shoqëria e gjerë.

Nënfushat më të mëdha të psikologjisë janë:

Psikologjia e zhvillimit e cila studion të gjitha aspektet e rritjes dhe zhvillimit të njeriut si fizike, mendore, shoqërore dhe emocionale. Psikologët e kësaj fushe ndahen në psikolog të fëmijërisë, psikolog të adoleshencës dhe së fundi psikologët e ciklit jetësor ku fokusohen tek sfidat dhe ndryshimet e moshës së pjekur që fillon me martesë dhe lindjen e fëmijëve e deri tek përmbushja e detyrimeve të punës e më tej përballimi i problemeve të tranzicionit në moshë të vjetër - deri në vdekje.

Psikologjia fiziologjike: Bazat biologjike të sjelljeve, mendimeve dhe emocioneve. Neuropsikologët interesohen se si ne i kontrollojmë mendimet, të folurit, zemërimin, dëshpërimin etj. Psikologët biologë studiojnë biokiminë dhe se si hormonet ndikojnë në jetën dhe në psikikën e njeriut. Gjenetistët gjithashtu mirren me shume pyetje për gjenomin njerëzor ADN etj.

Psikologjia eksperimentale: Si arrijnë njërëzit të mbajnë mend informacionin që marrin, a ka dallim se si gratë dhe burrat i zgjedhin problemet e ndërlikuara? Pse disa njerëz gjithmonë kërkojnë të shkëlqejnë në mësim, arte, sporte, etj satisfaksioni i lartë...

Psikologjia e personalitetit: studionë dallimet mes individëve për sa u përket tipareve të tilla si shoqërueshmëria, ndërgjegjja, stabiliteti emocional, vlerësimi për veten, prirjet agresive dhe aftësia për të qenë të hapur ndaj përvojave të reja. Gjithashtu kësaj fushe i intereson pse disa njerëz janë optimist e disa pesimistë, pse disa janë të shoqërueshëm e disa të tërhequr.

Psikologjia klinike dhe e këshillimit: kur kërkohet të përshkruajmë një psikolog shumë njerëz e përfytyrojnë punën e tij me një klinikë ku merren me pacientë dhe diagnoza –medikamente, mirëpo këto i aplikojnë klinikistët që merren me depresion apo ankth akut kurse psikologët këshillues merren me problemet e përditshmërisë dhe të përshtatjes me të cilat ndeshemi secili në çdo moment të jetës.

Psikologjia sociale: Ndikimet e njerëzve të tjerë tek marrja e vendimeve, mendimeve, përshtypjeve rreth situatave dhe ngjarjeve drejtuar vehtes dhe ndaj të tjerëve pra efektet e ndikimeve luajnë rol tejet të rëndësishëm në psikikën e njeriut. Psikologjia sociale studion çështje të tilla si tërheqjet ndërpersonale, komunikimin bindës, krijimin e qëndrimeve, bindjen ndaj autoritetit, respektimit të normave të grupit dhe se si njerëzit sillen ndryshe kur janë në turmë.

Psikologjia industriale-organizative e zbatuar në punë: parimet e psikologjisë vëhen në vendin e punës. Pra këta psikolog merren me çështje praktike si përzgjedhja dhe trajnimi i personelit, produktiviteti në punë, mirëqenja e punëtorëve, kushtet e punës, si dhe impakti i kompjuterizimit dhe automatizimit tek punëtorët.

Psikologët e punës përcaktojnë paraprakisht nëse një njeri është më i përshtatshëm për tu bërë shitës, pilot apo diçka tjetër. Niveli i moralit të grupit është faktor produktiviteti dhe për këtë arsye menaxherët konsullohen me psikologët për të pasur efektet pozitive. Pra, psikologu organizativ luan një rol të madh në botën e sotme moderne të punës.

Pesë çështjet bazë të fushave të psikologjisë

Çfarë kanë të përbashkët psikologët që studiojnë organizata dhe vende punë, çrregullimet psikologjike, kujesën dhe proceset kognitive gjenetikën e sjelljes apo dashurinë e fëmijës?

Të gjithë psikologët kanë të njëjtin interes për pesë çështjet bazë që dalin mbi specializimin e tyre të ngushtë dhe shkojnë në zemër të domethënjes së të qenit njeri.

Person -Situatë :Deri në ç'shikallë ndikohen sjelljet nga proceset e mbrendshme : si të menduarit, emocionet, motivet, qëndrimet!?

Deri në ç'shikallë ndikohet sjellja nga faktorët e jashtëm si materialiteti, rrethanat e mjedisit dhe prania e njerëzve të tjerë!?

Natyre –Edukatë:personi që ne bëhemi kur të rritemi është produkt i prirjeve të trashëguara apo pasqyrim i përvojave dhe edukatës gjatë rritjes tonë!?Diskutim i hapur shkencor.

Stabilitet-Ndryshim: a jemi i njëjti person me karakteristikat fëmijërore të fiksuara apo ndryshojmë gjatë ciklit jetësor!?Shembull si ndikoi lufta e Kosovës në sjelljet e gjeneratave më në moshë para dhe mbas saj!?

Diversitet-Universalitet: Ideja jonë për sjelljet njerëzore a i përshtatet po aq mirë çdo qenje njerëzore, çdo race, femrave më shume a meshkujve!?Duke qenë se njerëzit ndryshojnë në pamje, në ndjenja dhe në sjellje diversiteti dhe universaliteti janë pjesë e pandashme e jetës psikike të njeriut.



Psikologjia Organizative: Fusha e psikologjisë organizative i kushton vëmendje zhvillimit dhe aplikimit të teorive psikologjike në vendin e punës. Në të kaluarën termi “psikologjia profesionale” është përdorur por pasi që fusha është zgjeruar, titulli është ndryshuar.

Psikologjia profesionale fokusohet në profesione apo punë, ndërsa psikologjia organizative ekzaminon tërë organizatën ku këto profesione (punë) bëjnë pjesë.

Një “montues” është një profesion; organizata britanike e fluturimeve punëson montues mirëpo praktikant e punës për profesionin e njëjtë ndodh që ndryshojnë nga organizata e veturave Ford në pikpamje të veprimeve , përgjegjësi dhe organizimit të punës.

Teoritë nga shumë fusha të psikologjisë formojnë bazën për punë në psikologjinë organizative. Vëmendja, perceptimi dhe teoritë kognitive janë të rëndësishme në dizajnimin e detyrave të punës brenda kapacitetit njerëzor dhe për të tërhequr vëmendjen në sinjalet kur gjërat shkojnë gabim. Teoritë e mësimin dhe të kujtesës mund të tregojnë metodat më të mira të trajnimit për punë dhe punë praktike.

Teoritë e psikologjisë sociale janë të aplikuara në vende pune: në fushat si kohezioni i grupit, lidhshipi (udhëheqja) , motivimi, qëndrimet dhe atributet janë shumë relevante në vendin e punës. Psikometrika, matja e personalitetit të njeriut dhe funksionimi kognitiv është një fushë që po përparon në psikologjinë organizative, në selektim, trajnim dhe ndërtimin e ekipeve (grupeve) t ë personelit (stafit).

Psikologjia fiziologjike jep një vështrim mbi mardhëniet në mes funksionimit mental dhe fizik të njerëzve në pune, dhe sidomos është e rëndësishme për identifikimin e lëmive problematike siç është stresi.

Psikologjia organizative e ka qëllimin për aplikimin e teorisë në praktikë. Më në fund ekziston një mënyrë për të “shitur” psikologjinë – ankimi i vjetër (Aristoreli, Platoni , Hipokrati) thoshte se ne nuk mund ta hëkjmë qafe psikologjinë.

Si psikologë ne është dashur të dijme se njerëzit nuk e vlerësojnë çka u jipet ata preferojnë të paguajnë për të.



Metodat kërkimore në psikologji

Të gjitha shkencat përfshirë psikologjinë ,sociologjinë ekonominë shkencat politike , mjekësinë kërkojnë fakte të bazuara në vëzhgime të kujdeshme dhe në eksperimente.Për mbledhjen e të dhënave në mënyrë sistematike dhe objektive, psikologët përdorin një numër metodash kërkimore duke përfshirë :

Vëzhgimin në natyrë:kjo metodë përdoret për të vëzhguar sjelljet e njerëzve apo dhe kafshëve në natyrë.Një shembull konkret I vëzhgimit është kur një fëmijë e shohim nga brenda shtëpisë se si luan jashtë, si reagon sa është agresiv sa është I tolerueshëm etj.Kjo metodë të metat e veta I ka se një sjellje e vëzhguar në natyrë e ka vetëm një episod dhe nuk mundet të përsëritet natyrshëm prap për të analizuar mëpastaj në mënyrë laboratorike dhe gjithashtu nuk lejohen intervenimet.

Rastet studimore:përshkrimi I hollësishëm I një personi apo pak personave.Psikologu Piazhë zhvilloi një teori të plotë të zhvillimit konjitiv duke studjuar me kujdes secilin prej tre fëmijëve të tij në kohën që ata rriteshin dhe ndryshonin gjatë periudhës së fëmijërisë.Por duke qenë se secili njeri është unikal nuk mund të nxirren përfundime të besueshme , vetëm se hulumtuesit falë kësaj metode kanë zbuluar disa funksione tejet të rëndësishme të trurit nga disa pacient me dëmtimet që I kanë pësuar askidentalisht.

Pyetësorët: formulimit të pyetjeve u kushtohet vëmendje e veçantë për të siguruar informata shembull nëse pyeten prindërit “A përdorni ndëshkimin fizik për t’I disiplinuar fëmijët” dhe përgjigjja natyrisht se na del ‘Jo” por pyetja si: “kur e keni qëlluar për herë të fundit me shpullë fëmijën “ose “ në çfarë situatash mendoni se mundet të qëllohet fëmiju” kanë më shumë gjasa hulumtuesit që të marrin përgjigje më të sinqerta .

Këto tre metodat e lartpërmendura mund të sigurojnë të dhëna të shumta si sjelljet , mendimet opinionet dhe qëndrimet por nuk janë vendimtare sepse kërkimet vazhdojnë edhe me metoda më të fuqishme e ato janë:

Kërkimet korrelacionale dhe lidhjet shkak-pasojë . Korrelacion do të thotë mardhënia ose lidhja me disa faktorë shembull njerëzit që kalojnë stresse të rënda janë më të prirur të sëmuren fizikisht sesa ata që nuk stresohen,ose kur ndokush ka nevojë për ndihmë, sa më shumë njerëz të ketë përreth, aq më pak gjasa ka që të dal ndonjëri t’I ndihmoj.

Kërkimi eksperimental kur mirret për hulumtim një grup personash dhe vihen në gjumë për të matur më pastaj kujtesën por eksperimentet zakonisht janë me disa kufizime sepse ambient I laboratorit mund të ndikojë në sjelljet e subjektëve që kanë për bazë eksperimentuesit të masin sjelljet ,te nxëniti ,motivet

Mendimi kritik -Përdoruesit e internetit -vetmia, obeziteti, rritja e kriminalitetit tek adoleshentët, tërheqja nga rrethi social, janë disa shembuj të shkakut dhe pasojës Shkencëtarët nëpër botë nuk japin përgjigje se interneti ka më shumë anë pozitive apo negative. Detyrë e grupit : Si e shihni ju zhvillimin e hovshëm kibernetik duke i përfshirë anët pozitive teknologjike të qasjes së lehtë për shumë zgjidhje të detyrave dhe negative me shembuj konkret të lartpërmendur?

Mars, 2015

Mr.Sc.Besa Beqiri Zejnullahu

